

A janë zgjedhjet lokale mollë sherri për bllokadën institucionale? FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK) SHPREH SHQETËSIMIN E SAJ PËR MUNGESËN E PËRKRAHJES INSTITUCIONALE FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E KOSTOVE TË MBROJTJES LIGJORE PËR ÇLIRIMTARËT NË HAGË

OVLUÇK-ja, LETËR HAXHIUT: SIGURONI MJETET FINANCIARE PËR MBROJTJEN E PJESËTARËVE TË UÇK-së NË HAGË FAQE 4-5



Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), duke vlerësuar situatën e krijuar së fundmi, lidhur me mungesën e sigurimit të mjeteve financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës

për mbrojtjen e pjesëtarëve të UÇK-së në Hagë, i është drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, nga e cila kërkon sigurim të mjeteve financiare për mbrojtjen e pjesëtarëve të UÇK-së në Hagë. OVLUÇK-ja ka

theksuar se mosreagimi i institucioneve në këtë drejtim do të përbente një neglizhencë serioze me pasoja të rënda, duke dëmtuar jo vetëm individët konkretë, por edhe dinjitetin e luftës sonë për liri

'KTHESA E MADHE' E JAKUP KRASNIQIT ËSHTË DËSHMIA MË E FUQISHME PËR PAFAJËSINË E DREJTUESVE TË UÇK-SË NË GJYKATËN SPECIALE F. 9



Milazim KRASNIQI

URAN ISMAILI: BASHKË MUND TA PËRFUNDJËMË EPOKËN E ZHGENJIMIT NË PRISHTINË F. 7



AKTUALE



SHBA-ja MIRATON SHITJEN POTENCIALE TË ARMËVE NË UKRAINË NË VLERA MILIONËSHE F. 2

SPIUNAZHI SFIDON SIGURINË NË KOSOVË F. 4

RAMË BISLIMI, KANDIDAT I AAK-së PËR KRYETAR TË SHITES F. 7

EKONOMI



EKSPORTI DHE IMPORTI SHËNUAN RITJE NË MUAJIN QERSHOR F. 8

MBYLLET PËRKOHËSISHT PISHINA E GËRMISË, U VËRTETUA SE UJI NUK I PLOTËSONTE STANDARDET F. 8

SPORT



PREKAZI: KRENAR DHE ME KOKËN LART PO LARGOHEM NGA FC MALISHEVA F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kriza me ujë mund ta detyrojë zhvendosjen e banorëve të Teheranit

TEHERANI, 24 KORRIK - Teherani është duke u përballur me krizë aq të madhe me ujin, prandaj 15 milionë banorët e tij mund të detyrohen të zhvendosen, kanë raportuar të enjten mediet iraniane, duke cituar presidentin e shtetit, Masoud Pezeshkian. “Situata është serioze dhe Teherani thuhet nuk ka më ujë”, është cituar të ketë thënë Pezeshkian. Sipas tij, nuk mund të përjashtohet mundësia e zhvendosjes nga qyteti si zgjidhje emergjente. Irani është duke u përballur me krizë uji në më shumë se 20 prej 31 provincave që ka. Agjencia

shtetërore e lajmeve IRNA ka raportuar se një prej rezervuarve më të mëdhenj të ujit mund të thahet plotësisht brenda 3-4 javëve. Nivelet kanë rënë nën 10 për qind në shtatë rezervuarë në këtë shtet, dy diga në janë tharë plotësisht, si dhe 80 për qind e rezervuarve janë pothuajse krejtësisht pa ujë. Ekspertë për klimën kanë thënë se furnizimet normale me ujë nuk do të jenë të mundshme edhe për dy muaj derisa shiu ta stabilizojë situatën. Pezeshkian ka thënë se disa vjet të thatësisë janë arsye për krizën

aktuale, por edhe politikat e kaluara qeveritare, në të cilat, sipas tij, është injoruar kjo krizë. Zyrat qeveritare dhe shkollat do të vazhdojnë të jenë të mbyllura deri të shtunën si pasojë e krizës. Shumë fabrika janë mbyllur, gjithashtu. Kritikët akuzojnë qeverinë qendrore dhe administratat e provincave për keqmenaxhim. Shumë banorë të Teheranit tashmë janë larguar nga kryeqyteti drejt provincave veriore në Detik Kaspik, të cilat nuk kanë probleme me furnizime.



Greqia mund t’ia bllokojë Turqisë qasjen në skemën e BE-së për mbrojtje

ATHINË, 24 KORRIK - Greqia e ka paralajmëruar Turqinë se mund t’ia bllokojë qasjen në një fond të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes, nëse Ankaraja nuk ofron garanci se armët nuk do të përdoren për ta shënjestruar Athinën. Greqia, vend anëtar i Bashkimit Evropian dhe Turqia fqinje kanë marrëdhënie të tensionuara me dekada lidhur me të drejtat e sovranitetit në Detin Egje, dhe së fundmi edhe për shkak të çështjeve të energjisë dhe migrimit. Turqia, vend anëtar i NATO-s, por jo edhe i bllokut evropian, e gëzon mundësinë që të ketë qasje në programet e BE-së për



industrinë e mbrojtjes dhe në programet e përbashkëta për prokurim, në kuadër të Iniciativës së BE-së për Veprim në Siguri, në vlerë të 150 miliardë eurove. Mirëpo kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis ka thënë se shteti i tij nuk do ta lejojë Turqinë të marrë pjesë në skemën e mbrojtjes, nëse vazhdon të kërcënojë me luftë kundër Greqisë dhe ia vë në pikëpyetje sovranitetin në Detin Egje. “Greqia nuk do ta lejojë këtë”, ka thënë lideri konservator për televizionin Skai. Turqia kërcënon shpesh me luftë, në rast se Greqia i zgjeron

njëanshëm veprimet në ujërat e Egjeut. Mitsotakis e ka përmendur se do të duhet pajtueshmëria e 27 vendeve anëtare të BE-së, para se Turqia të ketë qasje në fondet e bllokut. “Kërkohet unanimitet”, ka deklaruar ai. Komentet e tij kanë ardhur disa orë pasi Gjermania ka thënë se e ka miratuar dërgimin e aeroplanëve Eurofighter në Turqi. Turqia është në bisedime me vite për blerjen e 40 aeroplanëve të tillë, të cilët prodhohen përmes një bashkëpunimi mes Gjermanisë, Britanisë, Italisë dhe Spanjës.

ShBA-ja miraton shitjen potenciale të armëve në Ukrainë në vlera milionëshe

UASHINGTON, 24 KORRIK - Shtetet e Bashkuara kanë miratuar shitjen e armëve në Ukrainë në vlerë të 322 milionë dollarëve për ta forcuar mbrojtjen e këtij shteti në ajër dhe fushëbetejë teksa përballet me pushtimin rus. Shitjet e pajisjeve HAWK për mbrojtje ajrore do të kushtojnë 172 milionë dollarë, derisa pajisjet luftarake të këmbësorisë Bradley do të kushtojnë 150 milionë dollarë, ka bërë të ditur Agjencia e Departamentit amerikan të Mbrojtjes për Siguri dhe Bashkëpunim. Pajisjet HAWK do t’i “përmirësojnë kapacitetet e Ukrainës për t’u përballur me kërcënimet e së tashmes dhe të ardhmes”, ka thënë kjo agjenci. Departamenti amerikan i Shtetit i ka miratuar shitjet dhe agjencia e Departamentit të Mbrojtjes e ka njoftuar Kongresin amerikan, i cili

duhet ta japë miratimin e fundit. Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë gjatë një takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, më 14 korrik, se planifikon të pajisë Ukrainën me armë në vlerë të “miliarda dollarëve” të cilat do t’i blejë aleanca veriatlantike. Në të njëjtën kohë, Trumpi i ka dhënë Rusisë një afat prej 50 ditësh për t’u pajtuar për një armëpushim, ose do t’i vendosë sanksione të ashpra. Miratimi i shitjes potenciale të këtyre armëve vjen pasi Pentagoni ka urdhëruar pezullim të dërgesave tjera në Ukrainë për t’i vlerësuar rezervat e veta, pavarësisht se Kievi është përballur me sulme të vazhdueshme me dronë dhe raketa. Sulmet kanë vazhduar edhe më 23 korrik, pasi forcat ruse kanë goditur portin e Odesas në Detin e Zi, duke përhapur flakë

në ndërtesa banimi. Në anën tjetër, dronët ukrainas kanë goditur territoret ruse, duke vrarë një person dhe duke plagosur një tjetër. Autoritetet ruse të avionit kanë thënë se i kanë pezulluar operacionet në aeroportin e Soçit për katër orë. Sulmet kanë ndodhur të njëjtën ditë kur Rusia dhe Ukraina janë pajtuar për këmbim të të burgosurve në negociatat e zhvilluara në Turqi. Në takim nuk është arritur përparim për kushtet e armëpushimit, dhe palët nuk janë marrë vesh për ndonjë takim në mes të liderëve të Ukrainës dhe Rusisë. “Kemi arritur përparim në aspektin humanitar dhe jo për ndalje të armiqësive”, ka thënë shefi i delegacionit ukrainas, Rustem Umerov, pas takimeve. Shefi negociator i palës ruse, Vladimir Medinsky i ka ripërsëritur thirrjet për



armëpushime 24 ose 48-orëshe për të mundësuar largimin e trupave të ushtarëve. Ukraina ka thënë se është e interesuar për armëpushim të menjëhershëm dhe afatgjatë. Sa i përket këmbimit të të burgosurve, Medinsky ka thënë se negociatorët janë pajtuar për t’i këmbyer mbi 1.200 të burgosur të luftës nga të dyja palët, dhe që Rusia është zotuar për dorëzim të

3.000 trupave të ushtarëve ukrainas. Medinsky ka thënë se edhe individët e plagosur rëndë do të këmbehen në front të luftës. Zelensky ka thënë se janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për këmbim. “Po presim kthimin e njerëzve tanë në shtëpi. Është shumë e rëndësishme që, pavarësisht gjithë vështirësive, ukrainasit të kthehen në shtëpi”, ka thënë ai.

A JANË ZGJEDHJET LOKALE MOLLË SHERRI PËR BLOKADËN INSTITUCIONALE?

Në Kosovë momentalisht nuk po ndodh asgjë dhe, njëkohësisht, po ndodh gjithçka. Asgjë, sepse në mungesë të një qeverie me kompetenca ekzekutive, shumë punë kanë mbetur pezull. Dhe, gjithçka, për faktin se çdo 48 orë që mbahet seancë për konstituimin e Kuvendit, del një tezë e re se pse është katandisur situata deri në këtë pikë. A janë zgjedhjet lokale faktori që fshihet prapa krizës?



PRISHTINË, 24 KORRIK - Ndonëse ende nuk janë finalizuar të gjithë hapat e domosdoshëm pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit - nisur nga konstituimi i Kuvendit, Kosova i ka nisur përgatitjet për një palë zgjedhje të reja, ato lokale, që do të mbahen më 12 tetor. Dhe janë pikërisht ato që përmenden secilën herë e më shumë si një tjetër faktor se pse partitë politike po qëndrojnë të gozhuara në qëndrimet e tyre, dhe nuk e kanë option kompromisin e bashkëpunimit për zhblokimin e ngërçit në Kuvend, që do t'i hapte rrugë edhe formimit të qeverisë së re. Deputetë, sikurse Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Besian Mustafa nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Time Kadriaj

nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), thonë për Radion Evropa e Lirë se nuk ekzistojnë matematika të tilla. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës mendon se në secilin proces zgjedhor, koalicionet qendrore e kanë diktuar dinamikën e bashkëpunimeve në nivelin lokal, por problemi më i madh tani qëndron te diskursi tejet i tensionuar i partive politike. “Publiku në Kosovë është ushqyer në javët dhe muajt e fundit nga një retorikë përçarëse, e cila e sheh bashkëpunimin me palën tjetër jo vetëm si të pamundur, por edhe si të gabuar e të padobishëm. Në njërën anë, duke i konsideruar partitë si pjesë të regjimeve të korruptuara, që është retorika e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), dhe

në anën tjetër, retorika e partive tjera në raport me LV-në, që bashkëpunimi me të është me dikë që e ka shkatërruar vendin përgjatë mandatit të fundit”. Sipas tij, subjektet politike do ta përdorin krizën aktuale për të ndikuar te votuesit e tyre. “Gara aktuale nuk është se kush do t'i formojë institucionet, por kujt do t'i bjerë faji në rast të dështimit për t'i zgjedhur ato. Retorika përçarëse mund të jetë kartë, e cila mobilizon votues, përderisa bashkëpunimi, për fat të keq, vijon të shihet si antivlerë”.

Pse nuk bashkëpunojnë PDK-ja, LDK-ja e AAK-ja me LV-në?

Për Tahirin nuk ekziston asnjë

kalkulim me vota dhe, sipas tij, PDK-ja e ka shtrirë dorën e bashkëpunimit për gjetjen e një kandidati të pranueshëm për kryeparlamentar, duke mos i përfshirë ministrat që kanë qenë në qeveri mandatin e kaluar. “PDK-ja nuk ka më ku të shkojë, nuk ka më ndonjë instrument që mund ta përdorë për zgjidhjen e këtij ngërçi. Ne kemi ofruar kompromisin, paçka se nuk jemi parti e parë dhe nuk na takon ta propozojmë kryetarin e Kuvendit”. Mustafa thotë se LDK-ja ka treguar qartë pse nuk dëshiron koalicion me LV-në. “Është gjuha e tyre dhe qasja e tyre polarizuese, edhe për shoqërinë, edhe për skenën politike. S'ka të bëjë asgjë me zgjedhjet lokale”. Kadriaj pohon se AAK-ja nuk dëshiron të bashkëpunojë me

LV-në, për shkak të “qeverisjes së saj të keqe” në mandatin e kaluar, dhe jo për ndonjë arsye tjetër. “Ju e dini që ne kemi dhënë propozime të cilat nuk janë mirëpritur, dhe tani është e drejta e tyre për sigurimin e shumicës së thjeshtë”.

Në anën tjetër, përfaqësues të partisë që ka fituar më së shumti vota më 9 shkurt, LV-së, nisur prej kryetarit të saj, Albin Kurti, kanë deklaruar disa herë se u kanë bërë oferta LDK-së dhe Nismës Socialdemokrate, por që ato nuk janë konkretizuar me marrëveshje.

Kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, beson se duhet arritur “zgjidhje përfundimtare, jo parciale”.

Cila mund të jetë zgjidhja?

Edhe politologu nga Prishtina, Dritëro Arifi, konsideron se zgjedhjet lokale mund të jenë njëri faktor pse partitë po hezitojnë që të bashkëpunojnë. Sipas tij, ato besojnë se tregojnë “dobësi” nëse bisedojnë me palën që deri dje e kanë akuzuar. “Janë ato vijat e kuqe të mençurisë dhe çmendurisë. Për fat të keq, ne e kemi kaluar vijën e kuqe të çmendurisë politike. Pra, shteti veç është dëmtuar. Natyrisht, përgjegjësia është te të gjithë 120 deputetët, por përgjegjësia shkon edhe sipas numrit të votave”. Sipas tij, vetëm “një koalicion i madh e shpëton vendin, pavarësisht se kush do të jetë kryeministër”. Kosova i ka mbajtur zgjedhjet e fundit lokale në tetor të vitit 2021.

LDK-ja pati fituar më së shumti komuna, pasuar nga LV-ja dhe PDK-ja. Shumica e kandidaturave për kryetarë komunash tashmë janë bërë publike.

Costa i shkruan Kamberit: BE-ja po ndjek me kujdes trajtimin e shqiptarëve në Serbi

Prishtinë, 24 korrik - Presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, në një letër drejtuar deputetit shqiptar në parlamentin serb, Shaip Kamberi, që mban datën 18 korrik, ka siguruar atë se BE-ja po ndjek me kujdes trajtimin e pakicave kombëtare, përfshirë edhe komunitetin shqiptar në Serbi. “Edhe një hap drejt internacionalizimit të çështjes së shqiptarëve të Luginës. Presidenti i Këshillit të Evropës, Antonio Costa, në

përgjigjen e tij ndaj letrës së dërguar me 25 shkurt 2025, më ka siguruar se BE-ja po ndjek me kujdes trajtimin e pakicave kombëtare, përfshirë edhe komunitetin shqiptar në Serbi. Sipas presidentit Costa, pakicat do të luajnë rol të rëndësishëm në kuadër të angazhimeve të Serbisë në procesin e anëtarësimit në BE. Nga Serbia pritet të përafrojnë kuadrin e saj ligjor për të drejtat e pakicave me standardet ndërkombëtare

dhe evropiane”, ka shkruar Kamberi në “Facebook”. Ai ka thënë se Këshilli i Evropës është i njoftuar hollësisht për çështjen e pasivizimit të adresave. “Kjo çështje është trajtuar edhe në raportet e zgjerimit të BE-së. Angazhimi i jonë për avancimin e pozitës së pakicave do të vazhdojë - BE dhe integrimi i rajonit në të, mbeten aspiratat tona të vetme politike!”, ka shkruar Kamberi.





SPIUNAZHI SFIDON SIGURINË NË KOSOVË

Siguria e Kosovës po rrezikohet nga raste spiunazhi të lidhura me shërbimet sekrete serbe. Arrestimet e fundit ngrenë shqetësime për përmasat e kërcënimit dhe gatishmërinë institucionale për t’u përballur me të

Prishtinë, 24 korrik - Veprimet e spiunazhit rrezikojnë drejtpërdrejt rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës si dhe sigurinë e zyrtarëve dhe qytetarëve të saj, thotë prokurori i Prokurorisë Speciale, Bekim Kodraliu. Megjithatë, ai siguron se kjo strukturë është e përgatitur dhe e gatshme të ndërmarrë veprime hetimore në çdo rast për raste të tilla. “Gjatë trajtimit të këtyre rasteve, Prokuroria vepron në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet e sigurisë në Kosovë”, thotë ai për Radion Evropë e Lirë. Si rezultat i kësaj pune, Kodraliu përmend në mënyrë të veçantë aktgjykimin e parë për spiunazh në Kosovë dhënë ish-zyrtarit policor, Aleksandar Vllajiq. Vllajiq u dënua më 5 qershor nga Gjykata Themelore në Prishtinë me pesë vjet burgim pasi pranoi se ishte përfshirë në spiunazh si anëtar i Agjencisë serbe të Inteligjencës dhe Sigurisë - BIA. Këtë muaj edhe një zyrtar tjetër policor i Kosovës, po ashtu me kombësi serbe, u dërgua në paraburgim nën dyshimet për spiunazh. Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, bëri me dije se Bojan Jevtiq “është i arrestuari i gjashtë me radhë në rastet e spiunazhit në Kosovë”, pa dhënë detaje mbi periudhën kohore të arrestimeve. Më herët këtë vit, Radio Evropa e Lirë raportoi për arrestimin e

Jellena Gjukanoviqit, serbe nga Kosova, nën akuzat për spiunazh. Në qershor të vitit të kaluar u arrestuan edhe Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi, pas dyshimeve se spiunuan te BIA.

A është Kosova nën një ofensivë të inteligjencës serbe?

Radio Evropa e Lirë pyeti Policinë e Kosovës nëse vendi është duke u përballur me një ofensivë të inteligjencës serbe dhe sa i përgatitur është për t’u kundërpërgjigjur, por nuk mori asnjë sqarim. Në një konferencë për medie më 22 korrik, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, tha se situata e sigurisë, në përgjithësi, është e qetë dhe stabile. “Ne i dimë qëllimet e politikës së Serbisë, sidomos të institucioneve të saj. Nuk është se gjithmonë kanë qenë - apo fare herë kanë qenë - në përkrahje të paqes dhe sigurisë në vendin tonë. Ne jemi të përgatitur për të gjitha sfidat që mund të ndodhin në vendin tonë”, tha Hoxha. Eksperti i sigurisë, Valdet Hoxha, nuk e përjashton mundësinë që shërbimet e vendeve jo mike - veçanërisht ato serbe - të jenë duke shfrytëzuar momentin. Ai thotë se periudhat e pasigurisë politike, si ajo që po kalon aktualisht Kosova, janë zakonisht të favorshme për aktivitetet të

padukshme si spiunazhi. Megjithatë, thekson se këto veprime nuk janë domosdoshmërisht të reja apo të lidhura vetëm me periudhën e fundit, pavarësisht arrestimeve.

Çfarë synon të dëmtojë spiunazhi?

Hoxha, i cili në të kaluarën ka shërbyer edhe si zëvendësministër i Punëve të Brendshme, shpjegon se spiunazhi, në thelb, synon dëmtimin e sigurisë kombëtare të Kosovës. “Ky aktivitet përpiket të dobësojë dhe komprometojë institucionet e shtetit, të shkaktojë dëme ekonomike, të nxisë konflikte të brendshme dhe veprime të tjera, që minojnë funksionimin normal të shtetit dhe krijojnë perceptimin e një shteti të dështuar”, thotë ai për Radion Evropë e Lirë. Po në të njëjtën frymë, Burim Ramadani, ish-kryeinspektor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, paralajmëron se inteligjenca serbe nuk ndalet për asnjë moment në përpjekjet për të destabilizuar Kosovën nga brenda. Sipas tij, ajo përdor çdo mundësi për të minuar themelet e shtetit dhe të demokracisë. “Serbia po vazhdon luftën speciale ndaj Kosovës, përfshirë këtu aktivitetet e spiunazhit, sabotimit, ndikimit në vendimmarrje dhe influencimit të komunitetit serb”, thotë Ramadani për Radion Evropë e Lirë. Viteve të fundit disa persona janë shpallur të padëshirueshëm në Kosovë dhe janë dëbuar, për shkak të rrezikimit të sigurisë kombëtare. Derisa dëmet e shkaktuara është vështirë të maten, sipas ekspertëve, Serbia vazhdimisht mbron se është e përfshirë në aktivitetet të tilla në Kosovë.

A është Kosova mjaftueshëm e përgatitur?

Përgjigjja nga të dy ekspertët është e prerë: po. Ramadani thekson se Kosova ka punuar vazhdimisht për të forcuar kapacitetet e saj kundër këtij kërcënimi. “Arrestimet dhe përballja me drejtësinë janë instrumente që parashihen në këto raste - kur është e domosdoshme. Ndërsa, pjesa tjetër e aktiviteteve përballuese lidhet me dobësimin dhe zhvleftësimin e këtyre ndërhyrjeve”, thotë ai. Hoxha, në anën tjetër, nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në fushën e inteligjencës, i cili, sipas tij, “është në nivel të shkëlqyer”. “Kosova, fatmirësisht, e ka ndërtuar kornizën ligjore për funksionimin e duhur të mekanizmave kompetentë në fushën e sigurisë”, thotë ai. Me Kodin Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me minimum pesë vjet burg, nëse konfirmohet fajësia.

Serbia si kërcënim i vazhdueshëm

Javëve të fundit udhëheqja shtetërore e Kosovës ka rritur veçanërisht zërin ndaj Serbisë, duke e cilësuar atë si burim të vazhdueshëm kërcënimi për sigurinë e vendit. Presidentja Vjosa Osmani tha më 15 korrik se Serbia, vazhdimisht, përpiket ta destabilizojë Kosovën - edhe me “akte agresioni”. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, reagoi ashpër ndaj deklaratave të

presidentit serb, Aleksandar Vuçiç, të bëra pas arrestimit të një zyrtari serb nga autoritetet kosovare, duke i quajtur ato kërcënuese dhe destabilizuese. Vuçiçi paralajmëroi “pasoja të paparashikueshme” pas arrestimit të Igor Popoviqit, ndihmësdrejtor në Zyrën për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, i cili u dërgua në paraburgim për “nxitje të përçarjes dhe mosdurimit”. Kurti, po ashtu, u bëri thirrje qytetarëve të Kosovës që të shmangin udhëtimin përmes Serbisë, pasi, siç tha, “ka indikacione” për provokime dhe ndalime arbitrare të qytetarëve të Kosovës. Përkallëzimi i fundit i madh i situatës në Kosovë ndodhi në shtator të vitit 2023, kur një grup i serbëve të armatosur, i udhëhequr nga Millan Radoiqiç, sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë, duke vrarë një polic. Prishtina e cilësoi atë si sulm terrorist dhe të orkestruar nga Serbia, por Beogradi mohoi çdo përgjegjësi. Në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës për vitet 2022-2027, Serbia përshkruhet si kërcënim i kryesor i sigurisë për Republikën e Kosovës. Për rrezikun e vazhdueshëm të tensioneve në Kosovë paralajmëroi këtë muaj edhe një raport i inteligjencës kroate. Në vazhdën e këtyre zhvillimeve, ish-zëvendësministri i Brendshëm i Kosovës, Valdet Hoxha, thekson nevojën për vigjilencë të vazhdueshme dhe masa të adaptueshme. Ai sugjeron përforcimin e bashkërendimit institucional, rritjen e bashkëpunimit me partnerët strategjikë dhe harmonizimin e kornizës ligjore, për të përballuar kërcënime - si spiunazhi e të tjera - në mënyrë efektive.

ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK) SHPREH SHQETËSIMIN E SAJ PËR MUNGESËN E PËRKRAHJES INSTITUCIONALE FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E KOSTOVE TË MBROJTJES LIGJORE PËR ÇLIRIMTARËT NË HAGË

OVLUÇK-JA, LETËR HAXHIUT: SIGURONI MJETET FINANCIARE PËR MBROJTJEN E PJESËTARËVE TË UÇK-së NË HAGË



Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), duke vlerësuar situatën e krijuar së fundmi, lidhur me mungesën e sigurimit të mjeteve financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e pjesëtarëve të UÇK-së në Hagë, i është drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, nga e cila kërkon siguri të mjeteve financiare për mbrojtjen e pjesëtarëve të UÇK-së në Hagë. OVLUÇK-ja ka theksuar se mosreagimi i institucioneve në këtë drejtim do të përbënte një neglizhencë serioze me pasoja të rënda, duke dëmtuar jo vetëm individët konkretë, por edhe dinjitetin e luftës sonë për liri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 KORRIK - Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke vlerësuar situatën e krijuar së fundmi lidhur me mungesën e sigurimit të mjeteve financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës, iu drejtua me një kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, nga e cila kërkon që urgjentisht të veprojë e të sigurojë fonde të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha shpenzimeve për mbrojtjen sa më të dinjitetshme të krerëve të UÇK-së. “Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) përmes kësaj letrë shpreh shqetësimin e thellë lidhur me mungesën e mbështetjes financiare

institucionale për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes juridike të të burgosurve në Dhomat e Specializuara në Hagë. Proceset që po zhvillohen në Hagë ndaj pjesëtarëve të UÇK-së përfaqësojnë jo vetëm individët, por edhe historinë e drejtë të luftës sonë çlirimtare. Mbrojtja adekuatë dhe profesionale e tyre është një domosdoshmëri themelore e drejtësisë dhe një detyrim moral e institucional i Republikës së Kosovës. Fatkeqësisht, mungesa e mjeteve financiare për të siguruar këtë mbrojtje po krijon një situatë serioze, e cila jo vetëm që cenon të drejtat elementare të të akuzuarave, por rrezikon që i tërë procesi të zhvillohet në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë. Kjo na bën të dyshojmë se pas kësaj

vonese qëndron një qëllim i paramenduar i mosmbështetjes, i cili bie ndesh me parimet kushtetuese të mbrojtjes së qytetarëve dhe garantimit të një procesi të drejtë ligjor. Në emër të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, kërkojmë me urgjencë: 1. Sigurimin e menjëhershëm të mjeteve të nevojshme financiare për mbrojtjen juridike të të burgosurve në Hagë; 2. Krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm që të bëjë mbikëqyrjen profesional të gjykatës; 3. Angazhim të drejtpërdrejt institucional për të garantuar që të gjithë të akuzuarit të kenë qasje të barabartë në mbrojtje të kualifikuar dhe të pavarur”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së. Ndër të tjera, theksohet se mosreagimi i institucioneve në këtë drejtim do të përbënte një neglizhencë serioze me pasoja të rënda, duke dëmtuar jo vetëm individët konkretë, por edhe dinjitetin e luftës sonë për liri. “Presim veprime të menjëhershme nga ana juaj si Ministri”, është theksuar në reagimin e OVLUÇK-së. Po të enjten Ministria e Drejtësisë ka njoftuar opinionin publik se nga fillimi i procesit gjyqësor pranë Dhomave të Specializuara në Hagë e deri më 24.07.2025 janë realizuar pagesa të rregullta në përputhje me marrëveshjet dhe obligimet e përcaktuara paraprakisht, në

funksion të përkrahjes së mbrojtjes juridike. “Nga fillimi i procesit në total janë paguar 32,944,287.77 euro (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent). Nga kjo shumë, për mbrojtjen e z. Hashim Thaçi janë shpenzuar total: 5,353,301.02 € (pesë milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e një euro e 2 cent). Pagesat janë realizuar në mënyrë të rregullt dhe transparente dhe do të vazhdojnë të bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe marrëveshjet në fuqi. Ministria e Drejtësisë mbetet e përkushtuar për të garantuar një proces të drejtë dhe të balancuar përmes përkrahjes së vazhdueshme juridike, në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut”, është thënë në reagimin e Ministrisë së Drejtësisë. Artan Behrami, deputet i Kuvendit të Kosovës, ka thënë se tash e disa herë Fondacioni “Përkrahje për Mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit” ka bërë kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë për financimin e mbrojtjes së ish-presidentit Thaçi, e cila përballat me Prokurorinë e Gjykatës Speciale me buxhet miliardësh. Ai ka thënë se Albulena Haxhiu i ka refuzuar të gjitha kërkesat. “Derisa, ky ekonomisti, i konvertuar përkohësisht në

jurist, Hekuran Murati, nuk kish haber për këto kërkesa. Pse me pasë? UÇK-ja, në botëkuptimin e Hekuranit dhe VV-së, edhe ashtu është një organizatë mercenarësh! Këta okupues të institucioneve, kur është fjala për familjarët e Fitore Pacollit, janë shumë zemërgjerë. Dhe shumë aktivë për të amnistuar Martinat, Nagipat dhe oligarkë të tjerë. Për UÇK-në nuk kanë para! Madje as fjalë të mira. Edhe atë në fazën më të rëndësishme të procesit, kur dëshmitarët e mbrojtjes do të jenë përcaktues për fitoren e krerëve të UÇK-së. Por, nashtë! Mirë që gjërat dalëngadalë po bëhen të qarta. Lirisht zhvishni kostumet me stemë të Republikës së Kosovës dhe vishni ato të Gjykatës Speciale. Me dhe pa mbështetje, ju dhe Gjykata Speciale betejën për ndërrim të historisë keni me humbël”, ka shkruar Behrami në “Facebook”. Astrit Kolaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar lidhur me rrezikun që ekipi i Hashim Thaçit të mbetet pa avokatin kryesor, Luka Misić. Kolaj ka thënë se Kosova është vonuar në mbështetjen financiare. Sipas tij, përkrahja nuk është ndërhyrje, por siguri i kushteve të barabarta. “Bartësit e institucioneve të Republikës së Kosovës e kanë obligim ligjor, nëse jo moral dhe politik, që të sigurojnë mbështetje financiare adekuatë për mbrojtjen juridike të qytetarëve të saj në këtë proces”, ka shkruar Kolaj në “Facebook”.

HASHIM THAÇI, SHTYLLË E REZISTENCËS KOMBËTARE, ARKITEKT I LIRISË, SHTETNDËRTIMIT DHE DINJITETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, METEOR I SHPALLJES SË PAVARËSISË

Autor: Prof. dr.
Fejzulla BERISHA
(Ekspert i së drejtës
publike)

I. Figura që mishëroi epokën e shtetformimit

Hashim Thaçi zë një vend qendror në historinë politike, juridike dhe diplomatike të Kosovës moderne. Nga një figurë e formuar në betejën për identitet, liri dhe vetëvendosje të popullit shqiptar të Kosovës, ai u bë ndër protagonistët kyç të shtetndërtimit dhe konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Me një profil të shumëdimensionuar - si lider politik, komandant i rezistencës, negociator ndërkombëtar, kryeministër dhe president - Thaçi mishëron vazhdimësinë historike të projektit për shtetësi dhe dinjitet kombëtar në trojet shqiptare.

II. Dimensioni politik i lidershipit - Nga lëvizja ilegale në drejtimin e shtetit

Ruga politike e Hashim Thaçit nuk fillon me strukturat formale të shtetit, por në themelet e një lëvizjeje ilegale, të organizuar përballë represionit sistematik të regjimit serb në Kosovë gjatë viteve '90. Si udhëheqës politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Thaçi e ndërkombëtarizoi luftën çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës, duke e shndërruar atë nga një konflikt i brendshëm i trajtuar me indiferencë ndërkombëtare, në një krizë globale që kërkoi ndërhyrje ushtarake të NATO-s. Roli i tij në Konferencën e Rambujesë (1999) u bë pikë kthese, ku Thaçi u paraqit si përfaqësuesi politik i vullnetit të popullit për liri, duke legjitimuar aspiratat kombëtare në një forum ndërkombëtar. Përballë mungesës së vullnetit të Serbisë për paqe dhe barazi, Hashim Thaçi dhe ekipi i tij politik refuzuan çdo zgjidhje që binte ndesh me të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje - një akt politik me përmasa historike.

III. Shtetndërtimi pasluftës - Arkitekt i institucioneve dhe themelues i republikës moderne

Pas përfundimit të luftës dhe çlirimit të Kosovës nga forcat serbe, Thaçi luajti rol kyç në

procesin e transformimit të lëvizjes çlirimtare në një strukturë të re politike e institucionale. Si themelues dhe lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ai udhëhoqi reformimin institucional të vendit, duke e kthyer Kosovën nga një territor nën administratë të përkohshme ndërkombëtare në një shtet me institucione të qëndrueshme, të orientuara drejt standardeve euroatlantike. Gjatë mandatit të tij si kryeministër (2008-2014), Thaçi udhëhoqi qeverinë që shpalli pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008, një akt politik dhe juridik me rëndësi themelore për arkitekturën ndërkombëtare të së drejtës dhe të rendit global. Ky akt nuk ishte vetëm një rezultat i brendshëm politik, por edhe kulmimi i një procesi të gjatë ndërkombëtarizimi të çështjes së Kosovës.

IV. Shpallja e Pavarësisë - një ngjarje me peshë ndërkombëtare

Shpallja e Pavarësisë, e lexuar nga Kryeministri Thaçi më 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Kosovës, përbën momentin më sublim të realizimit të të drejtës historike dhe juridike të popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje. Ky akt u

përgatit përmes një procesi shumëplanësh politik, diplomatik dhe juridik, i mbështetur fuqimisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet kyçe të Bashkimit Evropian. Kosova u shpall republikë e pavarur, sovranë dhe demokratike mbi baza të së drejtës ndërkombëtare dhe parimit të sui generis - një precedent unik, i njohur nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më 22 korrik 2010, e cila në mendimin e saj këshillimor legjitimoi shpalljen e pavarësisë dhe veçoi rastin e Kosovës nga rastet e tjera të ndarjes shtetërore. Thaçi, si udhëheqës i qeverisë dhe përfaqësues i Republikës së Kosovës në këtë proces, luajti një rol të dorës së parë në këtë sukses ndërkombëtar.

V. Roli presidencial - Diplomacia e shtetësisë dhe përfaqësimi global

Si President i Republikës (2016-2020), Hashim Thaçi kaloi nga funksioni ekzekutiv në atë simbolik e përfaqësues, por duke ruajtur dimensionin aktiv diplomatik. Ai u angazhua fuqishëm në promovimin e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës, forcimin e partneritetit strategjik me ShBA-në dhe në

procesin e konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të vendit në organizata multilaterale. Në këtë fazë, Thaçi mbrojti me vendosmëri vijat e kuqe të shtetësisë së Kosovës, duke refuzuar çdo formulë që binte ndesh me karakterin unitar dhe sovran të shtetit. Në qasjen e tij diplomatike mbizotëronte një filozofi proaktive, e orientuar drejt finalizimit të njohjes globale të Kosovës, sidomos përmes partneriteteve të fuqishme euroatlantike.

VI. Kontributi në dimensionin juridik ndërkombëtar - Një rast i përplasjes së drejtësisë dhe politikës

Rasti i ndjekjes së tij penale nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, megjithëse i diskutueshëm në aspektin e parimit të barazisë para ligjit dhe drejtësisë tranzicionale, e nxori në pah sfidën që Kosova si shtet i ri ballafaqohet me mbivendosjen e sistemit ndërkombëtar të drejtësisë mbi sovranitetin e saj të brendshëm. Megjithatë, qëndrimi institucional i Hashim Thaçit - dorëheqja nga posti i Presidentit për të përballuar procesin gjyqësor -

përbën shembull të lartë të përgjegjësisë shtetërore dhe besimit në parimet e drejtësisë, sado selektive qoftë ajo në realpolitikën ndërkombëtare.

VII. Një emër i lidhur me lirinë dhe identitetin kombëtar

Hashim Thaçi përfaqëson një brez të rrallë liderësh që i dhanë emër historisë dhe e formësuan realitetin politik të një kombi në liri. Figura e tij mbetet e lidhur pazgjidhshmërisht me çlirimin, shpalljen e pavarësisë dhe shtetndërtimin e Kosovës. Ai është jo vetëm protagonist i historisë sonë kombëtare moderne, por edhe një aktor me ndikim në transformimin e normave të së drejtës ndërkombëtare, sidomos në raport me të drejtën për vetëvendosje dhe ndërhyrjen humanitare. Hashim Thaçi mbetet meteor i shpalljes së pavarësisë, shtyllë e rezistencës kombëtare dhe arkitekt i lirisë institucionale e politike të Republikës së Kosovës. Në ndërgjegjen historike dhe juridike të kombit shqiptar, ai është shndërruar në simbolin e një epoke të ndritshme që shënoi kalimin nga robëria në sovranitet, nga dhuna në paqe dhe nga aspirata në realitet shtetëror.



Ramë Bislimi, kandidat i AAK-së për kryetar të Shtimes

Prishtinë, 24 korrik - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka njoftuar se kandidati i AAK-së për kryetar të Shtimes në zgjedhjet lokale është Ramë Bislimi. Haradinaj ka shkruar në “Facebook” se Ramë Bislimi është figurë e respektuar nga qytetarët, i njohur për maturi, ndershmëri dhe lidërsip të

natyrshëm. “Në Shtime, kandidati i Aleancës është z. Ramë Bislimi, një figurë e respektuar nga qytetarët, i njohur për maturi, ndershmëri dhe lidërsip të natyrshëm. Ramë Bislimi gëzon besimin e komunitetit dhe sjell me vete një përvojë të pasur dhe një përkushtim të palëkundur për

zhvillim ekonomik, mirëqenie dhe qeverisje transparente. Ai është garanci për një Shtime më të mirë, më të drejtë dhe më të organizuar”, ka shkruar Haradinaj. Haradinaj ka bërë me dije se edhe Bashkim Budakova do të jetë kandidat për kryetar të komunës së Lipjanit, një

profesionist me përvojë të gjatë në arsim dhe përfaqësues i dëshmuar i qytetarëve në Kuvendin Komunal. “Me këto dy kandidatura të fuqishme, Aleanca përmbyll nominimet në komuna, duke dëshmuar edhe njëherë vlerat që e udhëheqin; ndershmërinë, profesionalizmin dhe besimin



në qytetarin”, ka shkruar Haradinaj.

URAN ISMAILI: BASHKË MUND TA PËRFUNDOJMË EPOKËN E ZHGËNJIMIT NË PRISHTINË



Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka mbajtur të mërkurën mbërma takimin e parë me qytetarët në kuadër të programit të tij “Koha për Prishtinën”, ku ka paraqitur zgjidhet për Prishtinën dhe lagjet e saj. Përkrah tij në këtë ngjarje ishte edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili në fjalën e tij theksoi se Uran Ismaili është një lider që vepron me përkushtim dhe përgjegjësi dhe që nuk ndërmerr asgjë pa besim të plotë në misionin që merr përsipër. “Uran Ismaili ka qenë ministër i jashtëzakonshëm i Shëndetësisë, një shembull i

vendosmërisë dhe guximit për të marrë vendime pa u ndikuar nga askush. Ai është lider që i njeh problemet e Prishtinës dhe ka zgjidhje konkrete për to”, tha Krasniqi. Në fjalimin e tij, Uran Ismaili theksoi se qyteti ka nevojë për një model të ri qeverisjeje - një Prishtinë me trafik të rregulluar, pa qen endacakë, me ndriçim publik funksional, hapësira të pastra dhe zhvillim urban të planifikuar. “Kjo është Prishtina që do të nisë me qeverisjen time. Bashkë mund ta përfundojmë epokën e zhgënjimit në Prishtinë. Bashkë mund ta ndërtojmë një qytet të pastër, të gjelbër, të sigurt, me mundësi për të gjithë”, u shpreh ai. Ismaili përmendi edhe kritikët që i referohen kandidaturës së

tij si kandidat i PDK-së. Ai tha se “shënoi sukses si ministër i Shëndetësisë duke qenë në PDK dhe asgjë nuk e ndal atë për të punuar drejt për Prishtinën”. “Nuk kanë me thanë nuk ka përvojë. Nuk kanë me thanë s’ka ekip. Nuk kanë me thanë s’ka program. S’kanë me mujt me thanë asgjë për tiparet që e bëjnë një kryetar të mirë të Prishtinës. Por do të orientohen vetëm se unë jam PDK”, deklaroi ai. Zotimi i parë i Ismailit është rihapja e sheshit “Xhorxh Bush”, si hap i parë drejt zhbllokimit të trafikut. “Nuk jam unë kundër këmbësorëve, mirëpo jam kundër vendimeve të bëra pa plan, pa alternativa dhe pa vizion. Vendime të cilat e kanë vështirësuar jetën e qytetarëve të

Prishtinës. Mbyllja e sheshit... ka shfaqur edhe një mendësi qeverisëse e cila punën e fundit e bën të parën”, tha ai, duke shtuar se do të sigurohet që ky shesh të qëndrojë i hapur derisa të ketë një zgjidhje që nuk shkon në kurriz të qytetarëve. Zotimi i dytë lidhet me zhbllokimin e trafikut brenda 18 muajve. Ai tha se do të sigurojë 100 autobusë të rinj, do të vendosen 60 semaforë të rinj, do të ndërtohen pesë parkingje në hyrjet e qytetit dhe do të krijohet një qendër moderne e menaxhimit të trafikut. Po ashtu, premtoi zgjerimin dhe ndërtimin e trotuareve për lëvizje më të sigurt të këmbësorëve. Zotimi i tretë përfshin zgjidhje për qentë endacakë dhe ndriçim më të mirë publik. Ismaili tha se Prishtina nuk duhet të mbetet

qytet i errësirës dhe pasigurive nëpër lagje. Zotimi i katërt lidhet me pastërtinë. Ai u zotua për një sistem të përditshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, duke thënë se qyteti duhet të jetë i pastër 24/7, jo vetëm për fushatë. Zotimi i pestë ka të bëjë me ndërtimet pa plan dhe ruajtjen e hapësirave publike. Ismaili theksoi se do të vendoset rregull në zhvillimin urban dhe se lagjet nuk mund të sakrifkohen më për interesa ndërtimore. Ai kërkoi nga qytetarët ta mbajnë për fjalë rreth premtimeve të tij, duke u premtuar atyre se nuk do të lejojë asnjëri të futet mes tij dhe qytetarëve gjatë qeverisjes së ardhshme katërvjeçare të Prishtinës.

Drejt finalizimit të legjislacionit dytësor nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare

Prishtinë, 24 korrik - Të enjten është përmbyllur punësoria dyditore e grupit punues për hartimin e akteve nënligjore që dalin nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, e cila ka për qëllim përgatitjen dhe finalizimin e Projekt-Udhëzimit Administrativ për strehimin familjar. Qëllimi i udhëzimit administrativ është t’i

rregullojë kushtet për marrjen e shërbimeve të strehimit, llojet e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur në strehim familjar. Ky projekt udhëzim administrativ ka rëndësi jetike për realizimin e reformës në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, të rinjve, të rriturve dhe të moshuarve. Ministria e Drejtësisë mbetet e

përkushtuar për avancimin e politikave sociale dhe garantimin e qasjes së barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët. Mbështetja e UNICEF-it në këtë proces ka qenë e rëndësishme duke ofruar përkrahje të vazhdueshme në kompletimin e kuadrit ligjor dhe kontributin në reformën e shërbimeve sociale.



Mbyllet përkohësisht pishina e Gërmisë, u vërtetua se uji nuk i plotëson standardet

PRISHTINË, 24 KORRIK - Inspektorati Sanitar i Ministrisë së Shëndetësisë e ka mbyllur përkohësisht pishinën publike të Gërmisë në Prishtinë, pasi Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije të enjten se rezultatet e mostrave laboratorike që janë marrë prej aty kanë treguar se nuk janë plotësuar standardet për ujin. Menaxhimin e kësaj pishine e ka ndërmarrja publike “Sport Marketing”, ndërsa IKShPK-ja kryen kontrollin e cilësisë së ujit në kuadër të mandatit që ka për mbrojtjen e shëndetit publik. Kryetari i Prishtinës, Përparim

Rama, ka thënë për mediet lokale se është në kontakt me kompaninë për menaxhimin e pishinës. “E di që po merren me këtë çështje dhe më kanë lajmëruar që brenda këtyre ditëve edhe kjo çështje do të zgjidhet”. I pyetur nëse do të merren masa ndaj kompanisë menaxhuese, Rama ka thënë se do të analizohet se “çfarë vendime janë marrë dhe ku janë marrë”. “Do të ketë masa pas këtyre informatave që do t’i kemi”. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ekzistojnë një mori sëmundjesh që mund të shpërthejnë si pasojë e

mosplotësimit të standardeve nëpër pishina, përfshirë sëmundjet e frymëmarrjes dhe ato gastrointestinale. Në mesin e shqetësimeve të tjera përfshihen irritimi i syve dhe lëkurës dhe infeksione të ndryshme që manifestohen me diarre. Ky lajm vjen teksa qytetarët e Prishtinës janë në kërkim të hapësirave për freskim, teksa temperaturat arrijnë deri në 38 gradë celsius. IKShPK-ja ka thënë se ka marrë mostra të reja më 23 korrik dhe se rezultatet e tyre do të dalin të premtën. Pishina e Gërmisë është hapur këtë vit më 8 korrik.



EKSPORTI DHE IMPORTI SHËNUAN RRIJTJE NË MUAJIN QERSHOR

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin qershor 2025. Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 17,1 % në muajin qershor 2025 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024, gjegjësisht në vlerë prej 498,3 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 425,4 milionë eurosh në vitin 2024. Eksporti mbulon importin 13,9 %. Eksporti i mallrave në muajin qershor 2025 kishte vlerën 80,4 milionë euro, ndërsa importi 578,7 milionë euro, që është një rritje prej 9,5 % për eksport, si dhe një rritje prej 16 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 21,4 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, 12,5 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9,8 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; pijet dhe duhani; 6,7 % produktet minerale etj.



Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 14 % e përbëjnë produktet minerale; 13,2 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 13 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12,3 % e përbëjnë

mjetet e transportit; 8,6 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj. Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 27,6 milionë euro, ose rreth 34,4 % e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 10,7 %. Partnerët

kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (9,4 %), Italia (3,3 %), Holanda (3,2 %) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 249,6 milionë euro, ose 43,1 % e importeve të përgjithshme, me

një rritje prej 9,2 %. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (14,2 %), Polonia (5,2 %), Italia (4,7 %) etj. Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 36,9 milionë euro, ose 45,9 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 12,2 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (16,9 %), Maqedonia e Veriut (15,5 %), Mali i Zi (6,3 %), Serbia (5,7 %). Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 82,7 milionë euro, ose 14,3 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 28,1 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (5,1 %), Shqipëria (4,8 %), Serbia (3,4 %). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 15,9 milionë euro, ose 19,8 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (11,3 %) dhe Turqia (2,9 %). Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 246,4 milionë euro, ose 42,6 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (13,1 %) dhe Turqia (12,6 %).

Siguria në vendin e punës është përgjegjësi institucionale, thotë deputeti Berisha

PRISHTINË, 24 KORRIK - Deputeti i AAK-së, njëherësh edhe kandidat për kryetar të Prishtinës, Bekë Berisha, ka thënë se siguria në vendin e punës është përgjegjësi institucionale. “Katër qytetarë humbën jetën në vendin e tyre të punës brenda një periudhe të shkurtër kohore. Këto ngjarje nuk mund të cilësohen thjeshtë si aksidente, ato janë pasojë e mungesës së sigurisë, mosrespektimit të standardeve dhe neglizhencës institucionale.

Tashmë, me temperaturat e larta që po përfshijnë vendin, rreziku është edhe më i madh. Punëtorët fizikë, zjarrfikësit, policët dhe personeli shëndetësor janë çdo ditë në vijë të parë, duke rrezikuar jetën për t’i shërbyer të tjerëve”, ka shkruar Beka në “Facebook”. Ai ka kërkuar me urgjencë: Siguri të shtuar për të gjithë ata që punojnë në kushte ekstreme; Inspektime të rrepta në vendet e punës; Pajisje mbrojtëse dhe masa konkrete

për mbrojtjen e jetës së punëtorëve. “Ngushëllimet më të singerta për familjet që kanë humbur më të dashurit e tyre. Ne nuk mund të kthejmë jetët e humbura, por mund dhe duhet të veprojmë që kjo të mos ndodhë më. Respekt dhe mbështetje për zjarrfikësit, policinë dhe personelin shëndetësor, heronjtë tanë të përditshëm që përballen me sfida të shumta për sigurinë e qytetarëve tanë!”, ka shkruar Bekë Berisha.



‘KTHESA E MADHE’ E JAKUP KRASNIQIT ËSHTË DËSHMIA MË E FUQISHME PËR PAFAJËSINË E DREJTUESVE TË UÇK-së NË GJYKATËN SPECIALE



Milazim KRASNIQI

Gjykata Speciale, nëse ka synim të ndajë drejtësinë, librin e Jakup Krasniqit, “Kthesa e madhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, duhet ta ketë busull për vendimin e saj, e jo dëshmitë e rreme të dëshmitarëve të rekrutuar nga shërbimet armiqësore ndaj UÇK, ndaj Kosovës. Pse? Jakup Krasniqi e ka botuar në vitin 2006 këtë libër me kujtime, observime e vlerësime, nga pozita e njërit nga protagonistët e asaj lëvizjeje, duke pasur në posedim dokumentet më të rëndësishme të saj dhe pa e vrarë mendjen se rrëfimi i tij mund të jetë objekt i ndonjë procesi gjyqësor. Nuk ka bërë seleksionim, nuk ka bërë autocensurë. Pra dëshmitë e autorit janë të besueshme e jo të manipuluar, si ato të prokurorëve të Gjykatës Speciale. Autori librin e ka shkruar me idenë që të zbardhë sa më shumë të vërtetën për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pa ndier nevojë të fshehtë asgjë, pasi nuk ka fshehtë asgjë. Autori ka qenë i bindur se e vërteta që po rrëfente, do t’u ndihmonte të gjithëve që ta kuptojnë të vërtetën, pra edhe armiqve të UÇK-së, armiqve të Kosovës. Autori nuk e ka vrarë mendjen se mos ai vetë dhe libri i tij do të ndiqeshin penalisht për një veprimtari legale dhe çlirimtare që kanë zhvilluar. Pra, edhe nga ky aspekt, dëshmia e tij mund t’i hyjë më së shumti në punë Gjykatës Speciale, nëse e ka për qëllim ta kuptojë të vërtetën për UÇK-në dhe protagonistët që po gjykohej padrejtësisht në Gjykatën Speciale në Hagë. Për këtë rast do të ndajë me lexuesit disa fakte që dëshmojnë se akuza ndaj kreut politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sidomos ndaj Hashim Thaçit e Jakup Krasniqit, po edhe ndaj Kadri Veselit e Rexhep Selimit, është e montuar, pa mbështetje në fakte. Po e nis nga një kryefakt: deri sa përfaqësuesit politikë të UÇK-së po merrnin pjesë në delegacionin e përbashkët (edhe me LDK-në) në Konferencën e Rambujesë, komandantët e terrenit e kishin shkarkuar komandantin e përgjithshëm dhe e kishin emëruar një komandant të ri. Autori, duke qenë pjesëmarrës në konferencën e Rambujesë dhe pastaj në mbledhjen në terren ku u diskutuan ato ndryshime, ka

ngritur disa hipoteza mbi implikimin dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm përfshirë edhe segmente të shërbimeve konkrete sekrete. Këtë pistë Gjykata Speciale me gjasë e ka injoruar në tërësi, ndërsa shumë e mundshme duket që disa nga çrregullimet dhe krimet janë ideuar e mbase edhe kryer nga shërbime sekrete armiqësore. Gjykata do të duhej të gjente mënyra ta adresonte këtë pistë. Jakup Krasniqi pranon se ndryshimet që ishin bërë pa dijeninë dhe pa miratimin e kreut politik (në këtë rast Hashim Thaçit e Jakup Krasniqit, po edhe vetë Azem Sylës) u miratuan a posteriori nga kreu politik, vetëm për ta ruajtur unitetin. Pra, kreu politik kishte humbur në atë ballafaqim. Kjo provon se segmente të terrenit kishin ndikim më të madh se sa kreu politik. Po qe se Gjykata Speciale e pranon këtë gjendje faktike, pra të implikimit dhe ndikimit të shërbimeve sekrete armiqësore në njërën anë dhe të ndikimit dominues të njerëzve nga terreni, në anën tjetër, atëherë bie poshtë e tërë akuza ndaj drejtuesve politikë, Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit e Rexhep Selimit, që janë duke u gjykuar në Hagë. Askush nuk mund të gjykohej, nëse nuk ka qenë urdhërdhënës ose zbatues i veprimeve.


Nga dëshmitë që sjellë autori lidhur me Konferencën e Rambujesë, mund të kuptohet qëndrimi absurd i Gjykatës Speciale, e cila ka akuzuar figurat politike që kanë qenë pjesëmarrës në atë konferencë dhe kanë qenë vendimtar për firmosjen e Marrëveshjes së Parisit nga ana e Kosovës. Po qe se Gjykata do të kishte preokupim të zbulonte krimet eventuale, ajo do të duhej të orientohej drejt faktorëve konkretë, që kanë qenë kundër asaj konference dhe kundër firmosjes së asaj marrëveshjeje. Ndërsa, Gjykata është vënë në ndjekje penale të figurave kryesore, që e kanë shtyrë përpara firmosjen e Marrëveshjes së Rambujesë/Parisit. Çdo interpretim logjik do të jep konkluzionin se kjo Gjykatë po tenton një lloj hakmarrjeje ndaj atyre që mundësuan aktivizimin e NATO-s kundër caqeve ushtarake të Jugosllavisë (Serbisë.). Ky është absurd sui generis, meqë Gjykata financohet dhe vepron në truallin e shteteve të NATO-s (dhe BE-së.) Rezulton se kjo Gjykatë po tenton në mënyrë tinëzare që të akuzojë dhe dënojë edhe vetë NATO-n, për aleancën e saj funksionale me UÇK-në, në pengimin e spastrimit etnik dhe gjenocidit

serb në Kosovë. Kujt i duhet kjo ndërmarrje perverse, përveç armiqve të NATO-s? Dëshmia e Jakup Krasniqit në librin “Kthesa e madhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, për aktivitetin e tij edhe në lëvizjen paqësore, nëse respektohet si fakt, do ta rrëzonte çdo vendim penalizues që eventualisht do të mund të ndërmerrej kundër tij dhe krerëve të tjerë politikë të UÇK-së. Jakup Krasniqi, dëshmon se në kohën kur ishte i angazhuar në kreun e UÇK-së, vazhdonte të ishte kryetar i Degës së LDK-së në Glogovc (Drenas), duke shërbyer pra edhe në politikën paqësore që ndiqte LDK-ja. Ky fakt nuk mund të injorohet nga Gjykata Speciale, sepse dëshmon se autori përkatësisht i akuzuari Jakup Krasniqi, ka dhënë

QPK, ka qenë shumë i madh. Nuk e ka përjashtuar as mundësinë e integritetit të Bujar Bukoshit në atë qeveri, nëse do të ishte propozim yni e as ndryshimin e disa resorëve, për të fuqizuar LDK-në në atë qeveri. E vërteta të cilën autori Jakup Krasniqi nuk ka pasur si ta dijë është se hyrja e LDK-së në atë qeveri, e cila dukej punë e kryer dhe çështje e pak ditëve, (pritej kthimi i Bukoshit nga SHBA në Tiranë) u pengua nga mesazhi që dërgoi Rugova, për të ndërprerë ato kontakte, kur arriti në Romë pas lirimimit nga Beogradi, ku faktikisht ishte peng lufte i Millosheviqit. Pra, negociata për të cilat Jakup Krasniqi ka qenë i hapur dhe vullnetmirë, janë ndërprerë nga ana e LDK-së. (Në një takim që më vonë u zhvillua në Shkup me Rugovën, dolën në

UÇK-së. Kjo nuk zgjatë gjithmonë. Kosova dhe shqiptarët do ta kërkojnë drejtësinë dhe të vërtetën e historisë së tyre të lavdishme, deri në ditën e fundit në Tokë. Lidhur me formimin dhe veprimin e Gjykatës Speciale ka edhe disa gjera të tjera jologjike, të cilat katër të akuzuarit në Hagë thjesht i kanë shndërruar në pengje të lojërave konspirative diplomatike. Në këtë sfond, roli i administratës Obama, me Hilari Klintonin e Xhoe Bajdenin, në imponimin e Gjykatës Speciale, mbetet i pakuptueshëm, i palogjikshëm, absurd. A mund të jetë ai angazhim si pjesë e marrëveshjes xhentëllmene Tallbot-Çernomyrdin në Moskë dhe akordit të ministrave amerikanë e rusë në korrik 1999 në Helsinki? Pyetjet mbeten pezull, por Gjykata me vendosmërinë e saj për të dënuar me çdo kusht, me dëshmitarë të rremë, kreun politik të UÇK-së që nuk lejoi spastrimin etnik e gjenocidin serb e me vonë riintegrimin e Kosovës në ish Jugosllavi, duket si përgjigje konkrete. Pra, ka indikacione që gjykimi është produkt i akordeve të hershme të fshehta, të vitit 1999, për të shëruar egot e kompleksët ruse, e kurrësi një proces mirëfilli gjyqësor. Është në nivel të idiotizmit tentativa që shërimi i egove dhe komplekseve ruse të vitit 1999 të bëhet duke gjykuar aleatët e NATO-s të asaj kohe, pra, kreun politikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pa rolin e UÇK-së NATO nuk do të mund të hynte në Kosovë e as të krijonte kushtet për anëtarësim në NATO të shteteve ballkanike, Malit të Zi, Shqipërisë e Maqedonisë, pra forcimin e krahut jugor të NATO-s. Takimet dhe bisedat e Jakup Krasniqit, me kreun e NATO-s, me diplomatët e rëndësishëm perëndimorë në atë periudhë, të prezantuar me fakte në këtë libër, janë dëshmi e pakontestueshme e aleancës së UÇK-së me NATO-n dhe me Perëndimin. Këtë të vërtetë nuk mund ta ndryshojë asnjë gjykatë në botë. Për të vënë drejtësinë në vend, Gjykata Speciale do të mund të merrej me kryesit konkretë të krimeve e jo me gjykimin e kreut politik të UÇK-së që de facto kanë qenë partnerë i strategjisë së zgjerimit të NATO-s në Ballkan. PS. Nuk e di a është i përkthyer në anglisht libri i Jakup Krasniqi, “Kthesa e madhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës.” Nëse është, gjykatësit do të duhej ta kishin lexuar dhe ta kishin para sysh si një fakt të pakalueshëm për të dhënë drejtësinë përkatësisht për t’u dhënë pafajësinë autorit dhe shokëve të tij.

24 korrik 2025



kontribut në zgjidhjen paqësore të krizës. Vetëm kur është bindur se politika paqësore po dështonte, ai ka kërkuar angazhim me rrugë më aktive për ta mbrojtur popullin dhe Kosovën nga terrori ushtarak e policor i Serbisë. Edhe angazhimi i Jakup Krasniqit në delegacionin në Rambuje, qëndrimet konstruktive të tij, të cilat e kanë bërë që të pranohej edhe nga LDK-ja si kandidaturë për postin e kryeministrit në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, është dëshmi që nuk mund të anashkalohet as nga Gjykata Speciale e aq më pak nga historia e re e Kosovës. Në këtë kontekst mund të sjellë edhe një dëshmi/sqarim plotësues lidhur me takimet e një përfaqësie të LDK-së me Jakup Krasniqin në Tiranë, në maj 1999, të cilit i referohet autori në libër, në faqet 225-226. Meqë kam qenë një nga promotorët e atij takimi, mund të them si vijon: takimi vërtet ka qenë konstruktiv dhe vullneti i Jakupit për të gjetur një pajtim për inkuadrimin e LDK-së në

pah mospajtimet tona për këtë çështje, që sollën edhe largimin e disave prej nesh nga LDK-ja pas çlirimit të vendit.) Pra, mbetet fakt kokëfortë se po të varej nga vullneti i shprehur i Jakup Krasniqit, LDK do të bëhej pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, çka tregon qartë se ai nuk ka pasur asnjë ndjenjë refuzimi e aq më pak ndjenjë hakmarrjeje ndaj kundërshtarëve politikë. Ndërsa, po të formohej një qeveri e përbashkët në maj 1999, ashtu si insistonte edhe Jakup Krasniqi, menaxhimi i krizës së pas çlirimit, përfshirë veprimet e shërbimeve sekrete armiqësore dhe aktet e hakmarrjeve, do të menaxhohej me më shumë sukses dhe disa nga ato raste që janë sot në Hagë, nuk do të ndodhnin fare. Këto janë fakte të cilat nuk ka gjykatë në botë, pra as Gjykata Speciale, që mund t’i falsifikojë. Nuk besoj se duhet të inkurajohet askush në Gjykatën Speciale nga letargjia e tashme në Kosovë, e imponuar nga forcat politike fanatike kundër disave nga ish krerëve politikë të



Kosova po përgatitet për sfidën ndaj Rumanisë

Përfaqësuesja A e vajzave në voleyboll ka nisur fazën përgatitore në Skenderaj. Vashat “dardane” po stërviten me disiplinë dhe entuziazëm, ndërsa brenda ekipit

mbizotëron frymë e shëndoshë bashkëpunimi dhe besimi. Nën drejtimin e përzgjedhësit Lorik Ilazi dhe me mbështetjen profesionale të asistentëve Ylli Kadriu dhe Vlora Berisha, ekipi

është fokusuar maksimalisht në ndërtimin e formës optimale për sfidën e radhës ndaj Rumanisë. Kjo përballje zhvillohet në kuadër të kualifikimeve për

CEV EuroVolley 2026 dhe përbën një moment të rëndësishëm për rrugëtimin ndërkombëtar të voleybollit të Kosovës. Ndeshja do të zhvillohet më 2 gusht në

palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj, me fillim nga ora 20:00. Vashat e Kosovës janë të gatshme ta japin më të mirën për t’i përfaqësuar me dinjitet ngjyrat e Kosovës.

PREKAZI: KRENAR DHE ME KOKËN LART PO LARGOHEM NGA FC MALISHEVA

“Epoka e re”

MALISHEVË, 24 KORRIK - Një prej mbrojtësve më të mirë në Kosovë, Arbër Prekazi, ka konfirmuar largimin nga skuadra e Malishevës pas dy sezoneve të mbushura me përkushtim dhe sukses. Në një deklaratë publike ai ka falënderuar klubin dhe të gjithë ata që e kanë mbështetur gjatë kësaj periudhe. “Krenar dhe me kokën lart po largohem nga FC Malisheva pas dy viteve të mbushura me punë, djersë dhe sakrificë për këtë klub dhe për qytetin e Malishevës. Ishte një periudhë që nuk do ta harroj kurrë - me shumë emocione, suksese personale dhe arritje të përbashkëta. Faleminderit nga zemra bashkëlojtarëve të mi për respektin dhe vëllazërinë, presidentit dhe kryesisë për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme. Një falënderim i veçantë për ata tifozë që asnjëherë nuk na lanë vetëm. Gjithashtu, mirënjohje për punëtorët e klubit, Binak Gashi dhe Shpëtimin - dy figura që gjithmonë na rrinin afër me fanella e zhveshtore të pastër”, ka thënë Prekazi, duke shprehur mirënjohjen e tij të thellë për përvojën në klub. “Gjatë këtyre dy sezoneve arrita të kontribuoj me 4 gola dhe 4 asistime, mbi të gjitha jam krenar që, së bashku me shokët e skuadrës, hymë në historinë e klubit duke arritur objektivat dhe siguruar pjesëmarrjen në garat evropiane për dy vjet radhazi. Na dhashtë Zoti një të ardhme të hairit për të gjithë. Me respekt gjithmonë, njëri prej jush, ‘Preki’”, ka përfunduar Prekazi. Në skuadrën e Malishevës kanë ndodhur shumë ndryshime, përfshirë edhe largimin e trajnerit Bekim Isufi dhe komplet stafit të trajnerëve. Ky klub ka njoftuar se shumë shpejt do të vendoset për trajnerët që do t’i prijnë skuadrës në edicionin 2025/2026.

Fatjon Bunjaku nga Malisheva kalon te Elbasani

Sulmuesi i Malishevës, Fatjon Bunjaku, me shumë gjasë do ta vazhdojë karrierën te klubi elitari në Shqipëri, Elbasani. Pas një sezoni shumë të mirë me Malishevën, sulmuesi vushtrias



kishte disa oferta në tavolinë, por që vendosi të luajë në Kategorinë Superiore. Sulmuesi që shënoi pesë gola dhe dhuroi tri asistime, tashmë i është bashkangjitur Elbasanit. “Telegrafi” mëson se Elbasani ka paguar 50 mijë euro për kartonin e lojtarit, ndërsa Malisheva mban 30 për

qind të shumës nga shitja e ardhshme. Ai pas disa ditësh pritet të udhëtojë me ekipin në Kroaci për fazën përgatitore, ndërsa trajner i tij është Ivan Gvzodenoviq. Bunjaku ka luajtur më parë edhe te Trepça, Liria dhe Gjilani, ndërsa ka bartur fanellën e Kosovës U21 në katër ndeshje.

Ferizaj ‘blindon’ Nafiun, transferon Nezirin

Skuadra e Ferizajt e ka vazhduar kontratën me futbollistin e njohur Valmir Nafiun, kurse e ka transferuar Mexhit Nezirin. “Klubi ynë ka arritur marrëveshje me Valmir Nafiun për vazhdimin e kontratës edhe për sezonin 2025/26. Me përvojën dhe kontributin e tij të çmuar, Nafiun do të jetë sërish pjesë e rëndësishme e ekipit tonë në vazhdim të rrugëtimit në Superligë!”, ka njoftuar klubi ferizajas. Mexhit Neziri është mbrojtës me përvojë të madhe që ka zhvilluar karrierë në disa klube të Maqedonisë së Veriut. “Me një karrierë të pasur në futbollin vendor dhe ndërkombëtar, Neziri vjen pas paraqitjeve të rëndësishme me Shkëndijën, Renovën, Strugën dhe klube jashtë vendit. Mirë se vjen, Mexhit!”, thuhet në njoftim.

SHKURT

Milani nuk heq dorë nga Jashari

AC Milan po planifikon një raund të ri bisedimesh me Club Bruggen për transferimin e futbollistit shqiptar Ardon Jasharit pasi oferta prej 35 milionë eurosh plus bonuse është refuzuar. Skuadra belge kërkon 40 milionë euro dhe Milani pritet ta plotësojë këtë shifër së shpejti. Jashari ka marrëveshje personale me “Rossonerët” dhe ka refuzuar ofertat e West Hamit dhe Wolverhamptonit. 22-vjeçari, që kaloi te Brugge verën e kaluar nga Luzerni, ka kontratë deri në vitin 2029, por është shumë i interesuar për transferimin në Itali.

Leverkuseni kërkon 20 milionë për Xhakën

Transferimi i Granit Xhakës te skuadra e Sunderlandit po duket gjithnjë e më shumë si mision i pamundur. Përkundër që Xhaka ka marrëveshje personale me ekipin anglez dhe ka kërkuar largimin nga Bayer Leverkuseni, është klubi gjerman ai që po reziston. Mbi të gjitha, edhe trajneri i Leverkusenit, Eric ten Hag, ka insistuar se Xhaka nuk largohet për shkak se vlerësohet tejet i rëndësishëm për ekipin e tij. Mbi të gjitha, është çmimi që Leverkuseni i ka caktuar Sunderlandit për kartonin e Xhakës, duke kërkuar 20 milionë euro. Sunderlandi, i kthyer në Premierë Ligë, nuk e ka ndër mend të ofrojë mbi 10 milionë euro dhe kështu pritet që Xhaka të mbetet në Leverkusen. Mesfushori që ka kontratë deri në vitin 2028, i ka premtuar Leverkuseni se nëse transferimi i tij te Sunderlandi dështon, ai do të jetë 100 për qind i përkushtuar ndaj fanellës së ekipit gjerman në sezonin e ri.

LeBron James përballet me akuza tronditëse për doping

LeBron James është akuzuar për përdorim të dopingut gjatë kohës që luante për Miami Heat. Ish-lojtari i NBA-s, Jeff Teague, ka bërë një pretendim

skandaloz për përdorimin e steroideve nga superylli i Los Angeles Lakers, LeBron James. James ka pasur një karrierë legjendare në NBA dhe vazhdon

të shkëlqejë me Lakersin. Ai ka fituar katër kampionate të NBA-s në një karrierë që ka zgjatur mbi 20 vjet, duke luajtur më parë për Cleveland Cavaliersin

dhe Miami Heatin. Jamesi konsiderohet një nga më të mirët e të gjitha kohëve së bashku me emra si Michael Jordan dhe Kobe Bryant.

Qëndrueshmëria dhe dominimi i tij në NBA janë të pakrahasueshme dhe u diskutuan në podkastin e Teagues.

Real i përgatit 115 milionë euro për Rodrin

MADRID, 24 KORRIK - Klubi i Real Madridit, tani i drejtuar nga Xabi Alonso, është gati të bëjë një ofertë marramendëse prej 115 milionë eurosh për ta sjellë Rodrin në “Santiago Bernabeu”, raporton “The

Sun”. Kontrata e mesfushorit me Cityn është e vlefshme deri në verën e vitit 2027 dhe aktualisht nuk ka negociata për rinovim. Kjo situatë i ka dhënë shpresë Realit të veprojë në mënyrë të shpejtë për t’i siguruar shërbimet e

28-vjeçarit. Në Madrid, Rodri shihet si pasardhësi ideal i tandemës legjendare Toni Kroos - Luka Modriq dhe në “Los Blancos” mendojnë se ai ka potencialin për ta fituar edhe Topin e Artë pas paraqitjeve mbresëlënëse që

ka pasur si lider i padiskutueshëm në mesfushë. Nëse operacioni finalizohet, do të ishte një tjetër goditje e madhe në merkato për Real Madridin dhe një sfidë e re për Rodrin në vendlindjen e tij.



Rashfordi: Klubi ku ëndrrat bëhen realitet

BARCELONË, 24 KORRIK - Marcus Rashford paraqitet zyrtarisht lojtar i Barcelonës. Sulmuesi anglez do ta mbajë veshur fanellën e katalanasve, pas transferimit nga Manchester Unitedi në formë huazimi, me një klauzolë blerjeje për sezonin e ardhshëm me vlerë rreth 30 milionë paund. Rashfordi udhëtoi për në Spanjë gjatë fundjavës pasi mori autorizimin nga Unitedi për ta finalizuar marrëveshjen dhe tani transferimi është zyrtarizuar. Manchester Unitedi e përshëndeti me një mesazh të shkurtër: “Të gjithë te Manchester Unitedi i urojnë Marcusi fatin më të mirë për sezonin”. Sulmuesi anglez mbërriti në “Camp Nou” të mërkurën pasdite për ta nënshkruar kontratën dhe për ta finalizuar transferimin, duke pasur mundësinë të flasë për herë të parë me shtypin spanjoll. Në intervistën e tij të parë si lojtar



i Barcelonës, Rashford tha se ndihej “si në shtëpi” te klubi i tij i ri. “Barcelona është një klub ku ëndrrat bëhen realitet. Ajo që përfaqëson ky klub ka shumë rëndësi për mua, dhe ky ishte një faktor vendimtar në vendimin tim. Ndihej sikur po bëhem pjesë e një familjeje. Gjithmonë përpiqem të bëj veprime

vendimtare, lëvizje dinamike... Më pëlqen të shikoj futboll të bukur, gjithmonë kam qenë fans i mënyrës së lojës së Barçës”. “Dua t’i falënderoj tifozët katalanas për pritjen e ngrohtë. Është një ambient ndryshe për mua, por po e shijoj çdo moment. Siç e kam thënë tashmë, ndihem si në shtëpi”.

Toto Wolff zbulon dy pilotët e Mercedesit për vitin 2026

BRACKLEY, 24 KORRIK - Mercedesi ka kohë që po e kërkon Max Verstappenin, por Toto Wolff e dinte se shanset e tij për ta bindur holandezin të bashkohej varehin nga konkurrueshmëria si e makinës gjermane ashtu edhe e Red Bullit. Vështirësitë teknike të rivalëve e shtynë austriakun të niste një sulm të ripërtërirë disa javë më parë, por Max do të jetë ende faktori vendimtar. Verstappeni synon të presë deri në pushimet verore për ta vlerësuar progresin e Red Bullit, një aspekt që ai padyshim e konsideron të rëndësishëm për të arritur një vendim për vitin 2026. Shkarkimi i Christian Horner mund të interpretohet si përpjekja e Red Bullit për ta mbajtur kampionin e saj, rrethi i të cilit kishte pasur disa mosmarrëveshje me ish-drejtorin e ekipit. Ndaj, Wolff nuk mund të presë përgjithmonë dhe po ushtron presion mbi Verstappenin: “Grupi i pilotëve për vitin 2026 është një vendim që ka të bëjë jo vetëm me ekipin, por edhe me vetë pilotët, të



cilët duhet ta dinë situatën e tyre. Ne gjithmonë jemi përpjekur t’i përmbahemi këtij rregulli dhe do ta bëjmë këtë edhe këtë herë. Kjo do të thotë që në garën e Spa do të dimë me cilin ekip duam të garojmë në vitin 2026. Kur do ta shpallim nuk është ende plotësisht e sigurt”. “Diskutimet kanë ndodhur javët e fundit dhe të gjithë janë të informuar. Sidoqoftë, drejtimi që po marrim është të vazhdojmë të

punojmë me Georgen dhe Kimin. Kjo është përparësia kryesore. Natyrisht, nuk mund ta injorojmë Maxin dhe planet e tij për të ardhmen, por nuk mendoj se do të ketë ndonjë surprizë të madhe”, ka deklaruar Toto Wolff. Duket se nuk ka asnjë garanci se Mercedesi do ta ketë makinën më të mirë në vitin 2026, madje edhe me një njësi fuqie superiore, McLarenin po i tejkalon ata si klientë.

SHKURT

Kumbulla nuk bën pjesë në planet e Gasperinit, i pashmangshëm largimi nga Roma

Pas një sezoni thuajse të përkryer me Espanyolin në La Liga, ku zhvilloi 35 ndeshje si titullar absolut, Marash Kumbulla është rikthyer në Romë me shpresën për ta bindur trajnerin e ri Gian Piero Gasperini. Megjithatë, sipas raportimeve nga mediet italiane, qendërmbrojtësi i përfaqësueses shqiptare nuk bën pjesë në planet teknike të trajnerit të ri të verdhekuqve. Roma, e cila synon ta sistemojë mbrojtjen sipas kërkesave të Gasperinit, duhet të lirojë hapësira në repartin defensiv dhe Kumbulla është një nga emrat që pritet të largohet gjatë kësaj vere. Problemi kryesor në këtë pikë mbetet vlera e kartonit: Roma ka investuar mbi 20 milionë euro për ta transferuar nga Verona dhe nuk ka ndër mend ta shesë nën kosto. Për këtë arsye, zgjidhja më e mundshme është një tjetër huazim, dhe Espanyol, i kënaqur nga paraqitjet e tij sezonin e fundit, është gati t’i ofrojë sërish një vend titullari në Spanjë. Nëse nuk do të paraqiten oferta të rëndësishme nga Seria A, rruga për në La Liga mund të rihapet për Kumbullën, që kërkon të gjejë vazhdimësi dhe besim të plotë nga stafi teknik.

Federeri dhe Nadali ‘masin’ forcat në golf

Pasi sfiduan njëri-tjetrin për 20 vjet me radhë në fushat e tenisit, Roger Federer dhe Rafael Nadal kanë vendosur të ndryshojnë sport, duke mbajtur shkopinj në vend të raketave. Duke lënë tenisn për të luajtur golf. Dhe duket se po argëtohen, si miq të mirë të vjetër. “A është dikush gati të luajmë së bashku?”, ka qenë komenti i fotove që dy tenistët kanë postuar në “Instagram”. Këto foto janë shkrepur në Majorka, në shtëpinë e Nadalit, pak ditë pas vizitës që Federeri bëri në akademinë e spanjollit. Akademia e tenisit në Manacor është një laborator i vazhdueshëm idesh dhe mësimesh. Federeri e vizitoi atë disa ditë më parë, ndërkohë që i ka shijuar javët e fundit me një seri paraqitjesh: në Roland Garros dhe në Wimbledon. Sigurisht që zvicerani është pak prapa Nadalit në golf, pasi spanjolli luan për disa vite këtë sport, por ndjesia është se Federeri mezi pret ta ngushtojë hendekun shpejt. Dhe të nisin një tjetër rivalitet, këtë herë në një sport të ri.

Marseille synon ta rikthejë Neymarin në Evropë

Ish-sulmuesi i shumë klubeve evropiane, Neymar, mund të rikthehet në futbollin evropian, me Olympique de Marseille që po shfaq interesim konkret për sulmuesin brazilian. 33-vjeçari, aktualisht te Santos, po shqyrton opsione për t’u përgatitur për Kupën e Botës 2026 dhe një rikthim në Evropë shihet si vendimtar. Marseille ka nisur kontaktet dhe është gati të bëjë një përpjekje serioze si në aspektin financiar, po ashtu edhe sportiv, për t’i siguruar shërbimet e yllit brazilian. Neymari e sheh pozitivisht mundësinë për t’u bashkuar me një projekt ambicioz dhe për ta rifituar rolin e tij në elitën e futbollit evropian. Vendimi pritet në javët e ardhshme, me lojtarin që mbetet i fokusuar në një rikthim që mund të shënojë një kapitull të ri në karrierën e tij.

Benfica planifikon rikthimin e Joao Felix

Benfica është duke punuar intensivisht për ta rikthyer Joao Felix në “Estádio da Luz”, me bisedimet që tashmë kanë nisur mes klubit dhe agjentit të tij, Jorge

Mendes. Transferimi i sulmuesit portugez varet nga kushtet që do të vendosë Chelsea, ku Felix aktualisht është pjesë e skuadrës, por largimi i tij nga “blutë”

tashmë duket i sigurt. Felixi është shumë i motivuar për t’u kthyer te Benfica, klubi ku u formua si lojtar dhe nga shpërtheu në skenën ndërkombëtare.

Negociatat pritet të përshejtohen gjatë ditëve në vijim, ndërsa të gjitha palët janë optimiste për një marrëveshje. Nëse gjithçka shkon sipas planit,

rikthimi i Felixit do të ishte një nga transferimet më të bujshme të verës për klubin nga Lisbona, i cili synon ta forcojë skuadrën për sezonin e ri.



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjobiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master
1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555

044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjobiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjobiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjobiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



Gjej PUNË

• Lajme nga tregu i punes

• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erzen Tara shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

Krenare Kastrati shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -IX- të SHFMU “Abdyl Frashëri”, Prizren.

- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

